



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



DATË/A	23.12.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryeshefit Ekzekutiv te KRU-ve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vlerësimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura

Të nderuar,

Dokumenti i konsultimi publik publikuar në janar 2024 përfshinte një propozim për vlerësimin e shkarkimeve për ujërat e ndotura ku ujërat e ndotura të gjeneruara nuk janë një pasqyrim real i ujit që furnizon KRU-të. Tarifat aktuale për ujërat e ndotura supozojnë se ujërat e ndotura të gjeneruara për të gjithë konsumatorët është pak më i ulët se vëllimi i ujit që konsumatorët marrin nga KRU-të dhe është në të njëjtën proporcion për të gjithë konsumatorët. Ne e konsiderojmë këtë supozim si të vlefshëm për shumicën e konsumatorëve që janë të lidhur me sistemin e ujërave të ndotura.

ARRU është e vetëdijshme se për disa konsumatorë, ujërat e ndotura të gjeneruara mund të jenë dukshëm më shumë ose dukshëm më pak se volumi i ujit që marrin nga KRU-të. Kjo vlen kryesisht për një numër më të vogël të konsumatorëve shtëpiak (për të cilët ka evidencë), si dhe të konsumatorëve të mëdhenj komercialë dhe industrialë. Kjo diferencë mund të jetë për shkak se:

- Konsumatorët kanë burime shtesë të ujit përveç ujit që e marrin nga KRU-të, por që e shkarkojnë të gjithin ose pjesën më të madhe të ujërave të ndotura në gypat e kanalizimit që operohet nga KRU-të, p.sh. puset shtesë të ujit, mbledhja e ujërave të shiut, etj.
- Konsumatorët që gjenerojnë ujërat e ndotura nga produktet e papërpunuara si pjesë e proceseve të tyre prodhuese, p.sh. industria e djathit që gjeneron ujërat e ndotura nga përpunimi i qumështit.
- Konsumatorët që marrin shumë ujë nga KRU, por që shkarkojnë shumë pak ujëra të ndotura, p.sh. ujitja e tokave bujqësore.

Në këto raste, dhe shumë raste tjera, ARRU konsideron se metoda aktuale e faturimit bazuar në matjen e ujit që merret nga KRU-të nuk është kosto-reflektuese. ARRU konsideron se konsumatorët e tillë duhet të ngarkohen sipas vëllimit të vlerësuar të ujërave të ndotura të gjeneruara dhe jo bazuar në volumin e ujit që merret nga KRU-të.

Për qëllim të përcaktimit të tarifave, ngarkesat e vlerësuara nuk do të aplikohen për konsumatorët shtëpiak për procesin tarifor 2026-2028. ARRU mund të konsiderojë aplikimin e ngarkesave të vlerësuara për disa konsumatorë shtëpiak, e që do të mbështetet në evidenca dhe brenda kufijve të arsyeshmërisë së aplikimit.

Prandaj ARRU ju njofton formalisht se nga 1 janari 2026 korniza e përcaktimit të tarifave do të parashikojë aplikimin e ngarkesave volumetrike të vlerësuara të ujërave të ndotura për konsumatorët jo-shtëpiak, tek të cilët volumi i ujërave të ndotura të shkarkuara nuk është pasqyrim real i vëllimit të ujit që marrin nga KRU-të. Nga tani e deri në pjesën e parë të vitit 2025, gjatë kohës për përgatitjen e aplikimit tarifor 2026-2028, KRU-të duhet të identifikojnë të gjithë konsumatorët jo-shtëpiak për të cilët do të aplikohen ngarkesat volumetrike të vlerësuara për ujërat e ndotura. KRU-të do të përcaktojnë volumet aktuale të shkarkimit të ujërave të ndotura nga këta konsumatorë dhe volumet e tyre të parashikuara të ujërave të ndotura do të përfshihen në paraqitjet e planit të biznesit.

KRU-të së bashku me konsumatorët përkatës do të vendosin mekanizmat e nevojshëm për përcaktimin dhe zbatimin e tarifave të vlerësuara. Kjo mund të përfshijë matësin e ujërave të ndotura, matjen e sasisë së ujit prej burimeve tjera dhe metoda të tjera të përshtatshme. Konsiderojmë se vetë konsumatorët duhet të mbulojnë shpenzimet e blerjes dhe kostot tjera të çdo aparati matës dhe pajisjeve të tjera dhe kosto të tilla nuk duhet t'u kalojnë konsumatorëve të tjerë nëpërmjet tarifave. Ne kërkojmë që këto mekanizma të jenë gati para datës 1 janar 2026.

Prej tani e deri më 1 janar 2026, KRU-të do të përshtatin sistemet e tyre të faturimit për të insertuar ngarkesat volumetrike të vlerësuara të ujërave të ndotura.

Kërkojmë që të na mbani të informuar mbi progresin në lidhje me identifikimin e konsumatorëve që janë të përshtatshëm për tarifën e vlerësuara të ujërave të ndotura, vlerësimet e volumeve të tyre të shkarkimit të ujërave të ndotura, instalimin e çdo aparati të nevojshëm për aplikimin e ngarkesave të vlerësuara dhe ndryshimet e nevojshme në sistemet tuaja të faturimit.